



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 22.03.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 17.03.2021 të parashtruar nga Operatorit Ekonomik “PE-VLA-KU” sh.p.k.- Dega në Kosovë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i Qarkores – Tranziti i ri”, me Nr. të Prok: 632-19-2998-5-1-1 nxjerr:

V E N D I M

- 1. Refuzohet si** e pa bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik “PE-VLA-KU” sh.p.k.- Dega në Kosovë, e dt. 17.03.2021, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i Qarkores – Tranziti i ri”, me Nr. të Prok: 632-19-2998-5-1-1, kundër NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES , te AK –së, të datës 16.03.2021, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së .
- 2. Vërtetohet NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES të publikuar me datë: 16.03.2021;**
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që te vazhdoj me aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik “PE-VLA-KU” sh.p.k.- Dega në Kosovë,, me datë 17.03.2021, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i Qarkores – Tranziti i ri”, me Nr. të Prok: 632-19-2998-5-1-1,

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 22.03.2021, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi juaj se është refuzuar nga Autoriteti Kontraktues që t'ju jepet dosja e Operatorit Ekonomik Sh"Drini Company" sh.p.k, nuk qëndron sepse nuk është refuzuar t'ju jepet por jeni pyetur se a e doni prap pasi që disa herë e keni marrë dosjen në fjalë(sepse dosja e dorëzuar nuk ndryshon është e njëjta);

Autoriteti Kontraktues pas rishikimit të dokumenteve, dhe duke u mbështetur në nenin 1 të LPP-së, qëllimi i të cilit është të sigurojë mënyrën më efektive, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të Autoriteteve Kontraktuese në Kosovë, dhe të nenit 6 të këtij ligji sipas të cilit Autoritetet Kontraktuese janë të obliguara që të sigurojë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrë më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, konstaton se Grupi i Operatorve Ekonomik Sh"Drini Company" sh.p.k. i plotëson të gjitha kushtet e kërkuara në dosjen e tenderit dhe Autoriteti Kontraktues, mbetet pranë vendimit të marrë.

Sa u përket pretendimeve ndaj Operatorëve tjerë Ekonomik si:"Euroasphalt"sh.p.k. & "Trasing Group"shpk, dhe "Mirusha Company"sh.p.k. & "Lika Trade" shpk & "Infra Plus"shpk, këta Operatorë Ekonomik janë eliminuar sepse kanë qenë administrativisht të papërgjegjshëm.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.**

Eaton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit



Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;
Arkivit të Komunës